



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "HM HOME" Sh.P.K. të datës 19.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË** si e pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "HM HOME" Sh.P.K. të datës 19.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-6793-1-2-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi si dhe **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "HM HOME" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-6793-1-2-1.

Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. a) të RRPP është përcaktuar se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)". Në rastin konkret hapja e ofertave sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit është paracaktuar për datën 22.12.2025 (fakt jokontestues).

Përmes nenit 5 par. 1 të LPP përcaktohet se "Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit". Rrjedhimisht dita zero (0) është pikërisht data 22.12.2025 që nënkupton se afati për të parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka përfunduar me datë 16.12.2025 në ora 16:00. Duke marrë parasysh faktin se kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar me datë 19.12.2025, është gjetur se kërkesa është parashtruar me vonesë dhe si e tillë është e pasafatshme.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Sidoqoftë, lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se OSHP ka publikuar një vendim sipas të cilit autoriteti kontraktues ka të gjitha kërkesat e DT ashtu që ka adresuar të gjitha të gjeturat dhe konstatimet sipas vendimit të OSHP duke eliminuar apo ndryshuar/plotësuar të gjitha kërkesat që kanë mundur të jenë diskriminuese apo favorizuese. Kërkesat e mbetura në dosjen e tenderit jo vetëm që janë në përputhje të plotë me vendimin e lartcekur të OSHP, por si të tilla janë kërkesa absolutisht të domosdoshme dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.